



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opstina Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Transkript

Nga procesverbali i mbledhjes së III të Kuvendit Komunal i mbajtur me datën 26.02.2026 në ora 10:00 në sallën e KK-së, me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit
2. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës të kuvendit për vitin 2026
3. Propozim vendimi për themelimin e Komiteteve të KK Gjilan
4. Miratimi i listës së veçantë të pronave komunale për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues
5. Propozim vendimi për lirimin e përkohshëm nga obligimi i pagesës së gjobës komunale për regjistrime të mëvonshme të lindjes dhe vdekjes
6. Kërkesë për aprovimin e vlerësimeve të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për vitin 2025
7. Propozim vendimi për zgjedhjen e tre anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës
8. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB
9. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Stacioni i Autobusëve”
10. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Tregu”
11. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP “Eko-Higjiena “ (për pjesën publike të KRM “Higjiena”)
2. Të ndryshme

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit

Përveç anëtarëve të kuvendit në mbledhje prezantuan: Elijesa Rashiti, Isa Agushi, Haki Huruglica, Kadir Hysein, Enver Shabani, Elbasan Shabani, Bajram Isufi, Kushtrim Zeqiri, Mimoza K. Qerimi, Flakron Rexhepi, mediat e shkruara dhe ato elektronike.

Munguan: Leonora M. Bunjaku dhe Fatos Ramadani.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e Kuvendit Krenare L. Kqiku, e cila i përshëndeti të pranishmit dhe hapi mbledhjen me këtë rend pune.
Fillimisht i kemi 4 anëtarë të rinj të cilët do të japin betimin, ju kërkoj asamblistëve të japin betimin solemn.

2. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës të kuvendit për vitin 2026

Krenare L. Kqiku- sipas materialit që e keni para jush për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së kuvendit të komunës së Gjilanit për vitin 2026 me përbërjen prej 5 anëtarëve dhe unë si kryesuese e kuvendit të komunës dhe nga 1 anëtar prej gjitha subjekteve politike.

LVV, propozon Shpend Nuhiu.

LDK, propozon Sami Ahmeti.

PDK, propozon Liresë K. Ibrahim.

Nazim Gagica nuk dëgjohet incizimi kur flet anëtari i AAK-së.

VATRA, propozon Ali Selimi.

Me 32 vota për miratohet Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës të kuvendit për vitin 2026.

3. Propozim vendimi për themelimin e Komiteteve të KK Gjilan

Krenare L. Kqiku- ne këtu i kemi dy komitete obligative të cilat janë: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete.

Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej 9 anëtarëve dhe Komiteti për Komunitete përbëhet prej 7 anëtarëve.

Unë paraprakisht kam diskutuar me partitë politike ku kam kërkuar prej tyre që në këtë seancë të dalin veç me propozime konkrete dhe besoj se secili prej grupeve i ka propozimet dhe do të vazhdojmë me Komitetin për Politikë dhe Financa, e pastaj me Komitetin për Komunitete.

Ne e kemi tani shefin e subjektit tonë është mirë që edhe ju të deklaroheni për shefat e grupeve.

Prej LVV është Shpend Nuhiu.

LDK do ta konfirmojnë më vonë emrin.

PDK propozon Bujar Nevzatin.

AAK propozon Nazim Gagica.

Për Komitetin për Politikë dhe Financa, shefi i grupit të LVV, propozon anëtarët: Krenare L. Kqiku, Besnik Shala, Erestina Isufi dhe Shpend Nuhiu.

Krenare L. Kqiku- vetëm një gjë ta kemi parasysh që këtu kërkohet edhe përbërja e kuotës gjinore prej 4 anëtarëve që duhen me qenë gra.

Ne si LVV, jemi munduar ta respektojmë kuotën, ne si Lëvizje kemi respektuar kërkoj që edhe prej subjekteve tjera ta respektojnë të njëjtin gjë.

Sami Ahmeti- nuk dëgjohet diskutimi.

Krenare L. Kqiku- formula është me përbërjen e kuvendit me përqindjen e subjekteve politike në kuvend.

Përqindja më e madhe e subjektit politik është e LVV, sepse LVV e ka të drejtën në bazë të formulës dhe përqindjes saktësisht në bazë të përqindjes së anëtarëve që i keni në kuvend dhe LVV-së i takojnë 4 ulëse, LDK-së i takojnë 3 ulëse, PDK-së dhe AAK-së ju takon nga 1 ulëse. Kjo është formula.

Në bazë të rregullores te pika 2 thotë entiteti politik me numrin më të madh të vendeve varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend, do të përfaqësohet edhe në komitet.

Vazhdon me entitetin e dytë ashtu siç ju thash e kështu me radhë deri sa të ndahen të gjitha vendet me entitet.

D.m.th me këtë formulë plotësohet numri prej 9 anëtarëve ku unë jam duke e zbatuar rregulloren dhe udhëzimin administrativ.

Kërkoj prej grupit të LDK-së që t'i jap propozimet për 3 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Gentrit Murseli- si anëtar i kuvendit është shumë legjitime të kërkoj formulën e përqindjes qysh e keni llogarit që juve ju takojnë 4 anëtarë?

Shpend Nuhiu- secila parti politike e ka nga 1 përfaqësues, mandej kush ka më shumë përqindje 2, më shumë përqindje 3 dhe 4.

Bujar Nevzati - kërkon një pauzë 5 minuta.

Krenare L. Kqiku: pas takimit me përfaqësues të grupeve politike të kuvendit, besoj se u dakorduam t'i japin të gjithë përfaqësuesit e partive politike propozimet e veta. Për korrektësi e ftojë edhe njëherë grupin e LDK-së që të bëjë propozimin.

Arianit Sadiku- nuk dëgjohet diskutimi.

Bujar Nevzati- nuk dëgjohet diskutimi.

Krenare L. Kqiku- ju e dini shumë mirë që formula është shumë e qartë me pjesëmarrje me përqindjen e anëtarëve të kuvendit.

Nazim Gagica propozon **Nazim Gagica**.

Arianit Sadiku kërkon pauzë 5 minuta.

Krenare L. Kqiku- meqenëse i morëm propozimet e tri partive politike mbetet LDK dhe PDK brenda një kohe shumë të shkurtër që të plotësohen këto 2 komitete.

Edhe njëherë po i lexoj propozimet që i kemi marr, e mandej i hedhim në votim.

Krenare L. Kqiku

Erëstina Isufi

Shpend Nuhiu

Besnik Shala

Nazim Gagica

Me 18 vota për miratohet Propozim vendimi për caktimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Krenare L. Kqiku- tani e kemi propozim vendimin për Komitetin për Komunitete të komunës së Gjilanit.

Me këtë vendim caktohen anëtarët e komitetit për komunitete të komunës së Gjilanit, ku e ftojë Renan Imamin nga KDTP, që të jep propozimin.

KDTP, propozon Renan Imami dhe Emrah Ismail.

LVV propozon Albulenë Hajdari.

PDK propozon Malikie Hoxha

Lista Serbe propozon Daniela Stojanovic.

Komuniteti Romë propozon Fadil Demiroviq.

Me 33 vota për, miratohet propozim vendimi për caktimin e Komitetit për Komunitete.

4. Miratimi i listës së veçantë të pronave komunale për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues

Elijesa Rashiti - sipas ligjit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, komunat janë të obliguara që çdo vit ta hartojnë dhe miratojnë listën e veçantë të pronave komunale që planifikohen t'i japin në shfrytëzim gjatë vitit vijues.

Kjo listë duhet të publikohet zakonisht në web faqen zyrtare të komunës apo përmes mjeteve tjera të informimit publik.

Lista duhet të përmbajë të dhëna si: përshkrimin e pronës, lokacionin, sipërfaqen si dhe kushtet bazë të pronës në shfrytëzim.

Qëllimi i këtij është, që komuna të sigurojë transparencë, të garantojë barazi në konkurrencë, të mundësojë planifikim më të mirë ekonomik dhe zhvillimor në nivelin lokal.

Nëse komuna nuk e publikon këtë listë vjetore, kjo përbën shkelje të detyrimeve ligjore dhe mund të kontestohet përmes ankesës administrative, kërkesës për qasje në dokumente publike apo mekanizmave të mbikëqyrjes siç është MAPL.

Burhan Isufi- unë kam një pyetje lidhur me këtë çështje që ja drejtoj drejtorit të DSHPIB-së, përveç këtyre pronave meqë po jepen me qira.

A ka komuna plan të dhënies në shfrytëzim dhe hapësirave publike përbrenda qytetit dhe hyrje daljeve të qytetit për vendosjen e bilbordeve dhe reklamave të qytetit, si dhe pranë objektit të ekzekutivit përkatësisht aty ku ndodhet DBF, është i vendosur një bankomat në hapësirë komunale dhe gjitha këto që i ceka më lart dua një përgjigje se a ekzistojnë kontrata të rregullta për dhënien në shfrytëzim të këtyre hapësirave?

Cilat janë procedurat që janë ndjekur për këto hapësira, a inkasohen në mënyrë të rregullt në buxhetin komunal dhe a figurojnë këto pagesa në sistemin zyrtar të të hyrave?

Nëse jo tash, atëherë kërkoj që deri në seancën e radhës të ofrohen përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën që e bëra?

Sali Fazliu- obligimi i komunës për publikimin e listës së pronës komunale, pronave të paluajtshme komunale për dhënie në shfrytëzim, bëhet fjalë për pronat e paluajtshme komunale të cilat jepen në shfrytëzim për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Afatshkurtër është prej 1 deri në 15 vite, kurse afatgjatë është prej 15 vitesh deri në 99 vite.

Sa i përket çështjes së pronave, hapësirave publike para lokaleve afariste, sheshet, parqet ajo rregullohet me rregullore të veçantë.

Komuna e ka këtë rregullore dhe janë procedura të cilat ato prona jepen në shfrytëzim për periudhë më pak se 1 vit d.m.th. nuk është obligim i komunës të bëjë shpalljen të atyre pronave.

Me 32 vota për, miratohet, Miratimi i listës së veçantë të pronave komunale për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues.

5. Propozim vendimi për lirim të përkohshëm nga obligimi i pagesës së gjobës komunale për regjistrime të mëvonshme të lindjes dhe vdekjes

Elbasan Shabani: ky propozim, së pari duhet të ndryshohet, duhet të plotësohet në këtë vendim sepse janë vetëm lindjet apo vdekjet brenda vendit.

Pra në këtë vendim duhet me hy lindjet dhe vdekjet jashtë vendit, sepse janë vetëm brenda Gjilanit. Këtë vendim që nuk është vetëm vendim administrativ është edhe njerëzor, ky vendim synon lirim të përkohshëm nga pagesa e gjobave komunale për regjistrimet e mëvonshme të lindjeve dhe vdekjeve gjatë vitit 2026, prandaj kërkoj nga të gjithë këshilltarët që ta votojnë këtë vendim pas afatit ligjor prej 30 ditëve si dhe lindjeve apo vdekjeve jashtë vendit pas afatit prej 60 ditëve.

Me 33 vota për, miratohet Propozim vendimi për lirim të përkohshëm nga obligimi i pagesës së gjobës komunale për regjistrime të mëvonshme të lindjes dhe vdekjes.

6. Kërkesë për aprovimin e vlerësimeve të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për vitin 2025 dhe Kërkesa drejtuar Kuvendit Komunal për fatkeqësi natyrore gusht-dhjetor 2025

Muhamet Kqiku: në mungesë të kryesuesit të komisionit po ju flas në cilësinë e sekretarit të këtij komisioni në bazë të vendimit 02/57 me datë 16.01.2026 me vendim të kryetarit të Komunës Alban Hyseni është emëruar komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera që përfshinë periudhën nëntor 2025 dhe janar 2026.

Ky komision me marrjen apo delegimin e detyrave ka filluar punën pas analizimit dhe shtjellimit të të gjitha kërkesave.

Gjithsej numri i këtyre aplikacioneve ka qenë 247 aplikues, 157 aplikues kanë marr vlerësimin nga ky komision, 6 lëndë janë bartur në DSHPIB, ndërsa 84 lëndë, janë të refuzuara për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Komisioni në përbërje të inxhinierit të ndërtimitarisë Ridvan Aliut, Bejtullah Krasniqi dhe Driton Sylejmani, ka bërë analizimin dhe ky është raporti sa i përket komisionit.

Vlera e dëmeve është 293.653.66 €, ku unë kërkoj që këto kërkesa, të votohen në mënyrë që të vazhdojmë me procedura tjera në ministri.

Malikie Hoxha- pas vërshimeve të muajit nëntor të cilat shkaktuan dëme të konsiderueshme ekonomi familjare, biznese dhe infrastrukturë kritike përfshirë ura dhe rrugë është e rëndësishme që pas stabilizimit të situatës të filloj menjëherë meremetimi i tyre pasi që fatkeqësitë kërkojnë ndërhyrje për kthimin e funksioneve bazë.

Qëllimi kryesor është të mos krijohen pengesa shtesë për qarkullim dhe aktivitetet e përditshme. Aktualisht disa ura janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për të garantuar qarkullimin e sigurt dhe për të parandaluar rrezikun gjatë vërshimeve që mund të ndodhin në të ardhmen.

Në lagjen e Kurteshëve një urë ka rënë si pasojë e vërshimeve të muajit nëntor dhe kompanitë e kontraktuara vendosën gypa për të menaxhuar rrjedhjen e ujit nga lumenjtë e Kufcës dhe nga Stanishorka.

Megjithatë për shkak të prurjeve të mëdha të ujit me 10 janar, kjo ndërhyrje e përkohshme shkaktoi dëme të konsiderueshme veçanërisht në ekonomi familjare.

Kjo tregon se dikush duhet të marr përgjegjësi pasi këto ndërhyrje po kryhen me taksa të qytetarëve.

Këtu përfshihen: ura e rrugës qarkore ku bashkohen përrenjtë Stanishorka dhe Kufca, Ura e lagjes së Kurteshëve, ura që lidh Livoqin dhe Muhaxherët e Livoqit të Epërm, ura në Livoqin e Epërm. Qëllimi është parandalimi i dëmeve të mëtejshme gjatë vërshimeve që mund të ndodhin në të ardhmen.

Kërkesë shtesë disa banorë që kanë pësuar dëme nuk kanë aplikuar ende për kompensim kryesisht për shkak të mos informimit të duhur mbi rrugë dhe procedurën e aplikimit.

Disa familje kanë menduar se komisioni do t'i plotësoj vet aplikacionet gjatë vizitës në terren unë kërkoj që të njoftohen menjëherë këto familje në mënyrë që t'i paraqesin kërkesat për kompensim të dëmeve.

Erestina Isufi- diskutimi nuk dëgjohet.

Muhamet Kqiku- në mesin e aplikacioneve që i ka pranuar ky komision, ka edhe kërkesa që nuk kanë të bëjnë me dëmet e fundit për këtë arsye komisioni e ka vlerësuar që nuk ka fakte, prova të mjaftueshme me dokumentu që i njëjti dëm ka ardhur si për shkak të vërshimeve të fundit.

Në takimin e fundit që e kemi mbajtur me kryesuesin e komisionit të fatkeqësive natyrore e fatkeqësive tjera z. Kastriot Lajqi i cili është në nivel qendror na ka njoftuar që jemi vonë dhe duhet me procedu pak më shpejt procedurën.

Sami Ahmeti- pyetja ime është një fermeri në Gadish i është djegur stalla dhe bagëtia dhe nuk e dimë pse nuk është në këtë listë?

Pse nuk ka komision të ankesave?

Çfarë kritere janë marr për me u caktu shuma?

Me 31 vota për, miratohet Kërkesa për aprovimin e vlerësimeve të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për vitin 2025 dhe Kërkesa drejtuar Kuvendit Komunal për fatkeqësitë natyrore gusht-dhjetor 2025.

7. Propozim vendimi për zgjedhjen e tre anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Krenare L. Kqiku- fillimisht i jap fjalën shefit të grupit të LVV, t'i bëj propozimet për anëtarë të Asociacionit të komunave.

Shpend Nuhiu- prej LVV, propozon Krenare L. Kqiku si kryesuese, Astrit Sherifi, Albulena Hajdari dhe Shpend Nuhiu.

Krenare L. Kqiku- ne ju kemi referuar me një kërkesë Asociacionit të Komunave që kanë dhënë një propozim ku në propozim thuhet tre ose më shumë anëtarë të kuvendit, propozimi mund të vijë prej partive politike në kuvend dhe në këtë rast i kemi marr tre deri katër propozime me emrin tim, katër propozime nga grupi i PDK-së.

Gresa Avdiu- sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, po mendoj që jemi pak gabim në kuptimin e rendit të ditës për shkak se po thotë tre anëtarë të kuvendit të komunës, përfaqësojnë komunën e Gjilanit në asociacionin e komunave të Kosovës.

Secila parti propozon dhe partitë e mëdha propozojnë nga 1 anëtar dhe mendoj se jemi gabim në konceptin e pikës.

Mendoj që duhet ta propozojë 1 anëtar LVV, 1 LDK dhe 1 PDK, sepse kështu kemi vepruar edhe në mandatin e kaluar.

Krenare L. Kqiku- e di që kështu kemi vepruar në mandatin e kaluar, e di që gjitha partitë politike kanë pasur nga një përfaqësim, por kësaj radhe LVV ka të drejtë me vendos për 3 anëtarë.

Me 18 vota për, 1 kundër, miratohet Propozim vendimi për zgjedhjen e tre anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

8. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

Krenare L. Kqiku- për këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit, themelon këshillin komunal për siguri në bashkësi me këtë përbërje.

Përbërja është prej kryetarit të Komunës Alban Hysenit, ku gjithsej duhet me qenë 26 anëtarë ku kemi arritur t'i kontaktojmë 11 anëtarë që vazhdojnë me qenë në këtë grup punues, ndërsa anëtarët tjerë mbesin me u deklaruar në seancat e radhës.

Fitim Guda- unë nuk po mundem të gjej fjalë me shpreh ndjenjën e indinjatës në qasjen çfarë po bëni.

Së pari e keni ulur nivelin të qenit këshilltar, ka një titullar i cili duhet të përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit të kuvendit.

E para, pse nuk ka zërim, ne si LDK kemi ofruar frymën e bashkëpunimit, në çfarë forme propozoni 4 anëtarë kur keni mundësi të gjithë subjektet me i përfshi.

Ju në mënyrë tendencioze po tregoni që jeni përjashtues dhe nuk jeni për bashkëpunim.

Me 18 vota për miratohet Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB.

9. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Stacioni i Autobusëve”

Krenare L. Kqiku- propozoj që shefi i grupi t'i bëj propozimet për emërimin e anëtarëve.

Shpend Nuhju, propozon anëtarët Hekuran Rapuca dhe Astrit Sherifi.

10. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Tregu”

Shpend Nuhju, propozon anëtarët Besnik Shala dhe Fadil Ademi.

11. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP “Eko-Higjiëna “ (për pjesën publike të KRM “Higjiëna”)

Shpend Nuhju propozon Vebi Salihu dhe Laurant Shabani.

Me 18 vota për, 1 kundër miratohen 3 propozim vendimet NPL “Stacioni i Autobusëve”, NPL “Tregu” dhe PPP “Eko-Higjiëna”.

2. Të ndryshme

Në pikën në të ndryshme nuk pati diskutime.

Procesmbajtësja:

Arbresha Ismaili- Hyseni

A. Hyseni



Kryesuesja e KK

Krenare Latifi Kqiku
Krenare Latifi Kqiku

Vërejtje: të gjithë anëtarët që kanë marr fjalën nga vendi diskutimet e tyre nuk janë dëgjuar për shkak të zërimit të dobët.